

# RREGULLA TEKNIKE PER PRODHIMIN E MATERIALI SHUMEZUES TE ÇERTIFIKUAR PER *BERTHAMORET*.

- Rregullat e këtij Aneksi zbatohen për speciet frutore të mëposhtëme dhe për nënshartesat e tyre pa marrë parasysh nëse janë hibride apo specie të ndryshme botanike:
- *Qershi* (*Prunus avium* L., and *Prunus cerasus* L.)
- *Kajsi* ( *Prunus armeniaca* L.)
- *Bajame* (*Prunus amygdalus* Batsch.)
- *Pjeshkë* (*Prunus persica* L. Batsch.)
- *Kumbull* (*Prunus domestica* L., *Prunus salicina*, *Prunus triflora* dhe hibridet e tyre)

- Repozitori duhet të vendoset ne Institucionet shkencore
- Keto specie mund të shumëzohen me copa, farë ose nëpërmjet shartimit në bimë të së njejtës kategori.
- Materiali që nuk është konform kushteve të kërkuara ne kete Aneks nxirret jashtë proçesit të certifikimit.

Kontrollet shendetesore kryhen si me poshte:

a ) *Ne materialin parabaze dhe baze:*

- Kontrollet shendetesore duhet të kryhen konform protokolleve për secilën specie.
- Për viruset që trasmetohen mekanikisht, çdo bimë duhet të analizohet një herë në vit; për sëmundjet që nuk trasmetohen mekanikisht, është e mjaftueshme që çdo bimë të analizohet një herë në pesë vjet.

## *b) Ne bimet meme te certifikuara*

Mënyrat e kontrollit janë:

- a) *inspektim vizual*: që kryhet gjatë periudhës kur sëmundjet gjejnë shprehjen më të qartë simptomatologjike, si dhe në fryrjen e sytheve, në verë dhe para rënies së gjetheve.
- b) *analiza laboratorike*: këto kryhen me kërkesën e inspektorit.

Kontrollet per vertetesine gjenetike kryhen  
si me poshte:

- a) *Ne materialin parabaze dhe baze:*
- Çertifikimi për vërtetësinë varietale të pemëve frutore mund të lëshohet vetëm pasi të sigurohet një lidhje e bollshme e frutave që bën të mundur vrojtimin e vërtetësisë fenotipike të materialit.

- Çertifikimi për vërtetësinë varietale e nënshartesave klonale mund të lëshohet vetëm pas të paktën dy cikleve vjetore në fidanishte për tu kontrolluar vërtetësia fenotipike.
- Çertifikimi për vërtetësinë varietale të nënshartesave që vijnë nga fara dhe të farérave mund të lëshohen pas vrojtimit të një cikli të plotë në fidanishte e së paku 200 filizave për kultivarët që vijnë nga fara.
- Çertifikimi për vërtetësinë varietale duhet të caktohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit

## Vendi dhe menyra e inspektimeve:

- Inspektimet për materialin e marrë nga çdo pemë e katigorisë parabazë dhe bazë do të kryhet në vende të zgjedhura nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit. Gjatë dy viteve të para të prodhimit duhet të bëhen të paktën tre inspekte që përsëriten çdo vit gjatë vegjitacionit në: lulëzim, vjelje të frutave, rënie të gjetheve.
- Vrojtime më të imta në fenofaza të ndryshme dhe për karakteristikat morfologjike të pemëve bëhen për materialin në vrojtim.

## Ne bimet meme te çertifikuara:

- Vërtetësia varietale e bimëve mëmë të destinuara për prodhimin e materialit të çertifikuar do të kontrollohet në fazën e nxjerrjes së lastarëve dhe/ose lulëzim dhe në rënien e gjetheve për dy vitet e para.
- Kontrolle do të bëhen gjithashtu në vjeljen e frutave për një vit, në vitin e dytë, të tretë ose në vitin e katërt të lulëzimit.

Karakteristikat teknike qe duhet te permbushin Pemetoret meme dhe Fidanishtet me bime te çertifikueshme jane;

- a) Pemetoret mëmë të kultivarëve dhe të nëshartesave ;
- - Pemëtorja duhet të vendoset në kushte tokësore të mira, ku nuk janë kultivuar pemë frutore së paku për tre vjet.

- Toka duhet të jetë e pastër nga nematoda vektor të virusave.
- - Pemëtorja mëmë duhet të vendoset 100 metra larg nga çdo pemëtore tjeter, kur bimët janë për prodhimin e sytheve, 300 metra për prodhimin e farës, 600 metra për *Prunus mahaleb* dhe *P. avium* për prodhimin e farës.
- - Parcelat brenda pemëtorec duhen të janë homogjene dhe të identifikohen me lehtësi.
- - Në parcelë rreshtat duhet të dallohen sipas species dhe kultivarëve. Kur kultivarë të ndryshëm vendosen në të njëjtin rresht ato duhen të janë jo më pak se një metër larg.
- - Parcelat duhen të kenë një zonë mbrojtëse të paktën 3 metra e cila të jetë vazhdimisht e punuar dhe pa asnjë lloj vegjitacioni.

- - Blloqet mëmë për prodhimin e sythave nuk mund të mbahen më tepër se 10 vjet.
- - Bimët mëmë duhen të mbrohen mirë nga dëmtuesit dhe sëmundjet e ndryshme.
- - Bimët mëmë për prodhimin e sytheve duhen të rriten pa dhënë lule me përjashtim të fazës që lidhet me inspektimin e vërtetësisë varietale.
- - Blloqet mëmë duhen të izolohen nga rrjedhja e ujrave sipërfaqësore, uji vaditës duhet të jetë i pastër nga patogjenët dhe vektorët e tyre.

## Fidanishtet me bimë të certifikueshme duhet të përbushin

- - Fidanishtet duhen të vendosen në toka që plotësojnë kërkesat bujqësore dhe që nuk kanë kultivuar pemë frutore për të paktën tre vjet.
- - Toka duhet të jetë e pastër nga nematodat vektorë dhe ato endoparazite.
- - Fidanishtja duhet të ndahet në parcela homogjene dhe të identifikueshme qartë për varietete të ndryshme.

- - Parcela duhet të rrethohet nga një bord së paku 2 metra, i cili duhet të punohet dhe të pastrohet nga çdo lloj vegjetacioni.
- - Cdo rresht në parcelë duhet të përmbajë vetëm Prunoideae dhe kombinimet e ndryshme te shartimit duhet të vendosen në distancë një metër larg.
- - Fidanishtja duhet të mbrohet mirë nga dëmtuesit dhe sëmundjet.
- - Parcela duhet të jetë 10 metra larg nga pemëtoret e tjera.

Analizat nematologjike te tokes dhe te bimeve ne blloqet meme dhe ne fidanishte kryhen si me poshte:

- a) *Nematodat vektore te viruseve*
- Toka duhet të jetë e pastër nga *Longidorus elongatus*, *L. attenuatus*, *L. macrosoma* dhe *xiphinema diversicaudatum*, *X. rivesi*, *X americanum* dhe *X californicum*.
- Mostrat duhen të merren në pranverë dhe në vjeshtë para punimit të tokës.
- Për çdo hektar duhen të merren 10 mostra, secila prej tyre duhet të përbëhet nga jo më shumë se 5 nënmostra

## b) Nematodat endoparazite

- Toka duhet të jetë e pastër nga *Pratylenchus vulnus*, *P. penetrans*, *Meloidogyne incognita*, *M. javanica*, *M. arenaria*, *M. hapla* dhe *Circonemella xenoplax*.
- Për çdo hektar duhen të merren 10 mostra secila prej tyre duhet të përbëhet nga jo më shumë se 5 nënmostra.
- Mostrat duhen të dërgohen menjëherë në një laborator të njojur zyrtarisht.

## RREGULLA TEKNIKE PER PRODHIMIN E MATERIALI SHUMEZUES TE ÇERTIFIKUAR PER *BERTHAMORET*

- Rregullat e këtij Aneksi zbatohen për speciet frutore të mëposhtëme dhe për nënshartesat e tyre pa marrë parasysh nëse janë hibride apo specie të ndryshme botanike:
- *Qershi* (*Prunus avium* L., and *Prunus cerasus* L.)
- *Kajsi* (*Prunus armeniaca* L.)
- *Bajame* (*Prunus amygdalus* Batsch.)
- *Pjeshkë* (*Prunus persica* L. Batsch.)
- *Kumbull* (*Prunus domestica* L., *Prunus salicina*,  
*Prunus triflora* dhe hibridet e tyre)

## ***INSPEKTIME PER VERTETESINE GJENETIKE.***

- A) *NE MATERIALIN PARABAZE DHE BAZE*
- Çertifikimi për vërtetësinë varietale të pemëve frutore mund të lëshohet vetëm pasi të sigurohet një lidhje e bollshme e frutave që bën të mundur vrojtimin e vërtetësisë fenotipike të materialit.
- Çertifikimi për vërtetësinë varietale e nënshartesave klonale mund të lëshohet vetëm pas të paktën dy cikleve vjetore në fidanishte për tu kontrolluar vërtetësia fenotipike.
- Çertifikimi për vërtetësinë varietale të nënshartesave që vijnë nga fara dhe të farërave mund të lëshohen pas vrojimit të një cikli të plotë në fidanishte e së paku 200 filizave për kultivarët që vijnë nga fara.
- Çertifikimi për vërtetësinë varietale duhet të caktohet nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit.

## VENDI DHE MENYRA E INSPEKTIMEVE.

- Inspektimet për materialin e marrë nga çdo pemë e katigorisë parabazë dhe bazë do të kryhet në vende të zgjedhura nga DPBMB ne Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit pas aprovimit të Këshillit Tekniko - Shkencor.
- Gjatë dy viteve të para të prodhimit duhet të bëhen të paktën tre inspekte që përsëriten çdo vit gjatë vegjencionit në: lulëzim, vjelje të frutave, rënie të gjethive.
- Vrojtime më të imta në fenofaza të ndryshme dhe për karakteristikat morfologjike të pemëve do të bëhen për materialin në vrojtim

## B) NE BIMET MEME TE ÇERTIFIKUARA

- Vërtetësia varietale e bimëve mëmë të destinuara për prodhimin e materialit të çertifikuar do të kontrollohet në fazën e nxjerrjes së lastarëve dhe/ose lulëzim dhe në rënien e gjetheve për dy vitet e para.
- Kontrolle do të bëhen gjithashtu në vjetin e frutave për një vit, në vitin e dytë, të tretë ose në vitin e katërt të lulëzimit.

## KARAKTERISTIKA TEKNIKE PER PEMETORET MEME.

- Pemëtoria duhet të vendoset në kushte tokësore të mira, ku nuk janë kultivuar pemë frutore së paku për tre vjet.
- Toka duhet të jetë e pastër nga nematoda vektor të viruseve.
- Pemëtorja mëmë duhet të vendoset 100 metra larg nga çdo pemëtore tjeter, kur bimët janë për prodhimin e sytheve, 300 metra për prodhimin e farës, 600 metra për Prunus mahaleb dhe P. avium për prodhimin e farës.

- Parcelat brenda pemëtores duhen të jenë homogjene dhe të identifikohen me lehtësi.
- Në parcelë rreshtat duhet të dallohen sipas species dhe kultivarëve. Kur kultivarë të ndryshëm vendosen në të njëjtin rresht ato duhen të jenë jo më pak se një metër larg.
- Parcelat duhen të kenë një zonë mbrojtëse të paktën 3 metra e cila të jetë vazhdimisht e punuar dhe pa asnje lloj vegjitacioni.
- Blloqet mëmë për prodhimin e sythave nuk mund të mbahen më tepër se 10 vjet.
- Bimët mëmë duhen të mbrohen mirë nga dëmtuesit dhe sëmundjet e ndryshme.
- Bimët mëmë për prodhimin e sytheve duhen të rriten pa dhënë lule me përjashtim të fazës që lidhen me inspektimin e vërtetësisë varietale.
- Blloqet mëmë duhen të izolohen nga rrjedhja e ujrale sipërfaqësore, uji vaditës duhet të jetë i pastër nga patogjenët dhe vektorët e tyre.

## **KARAKTERISTIKA TEKNIKE PER FIDANISHTE ME BIME TE ÇERTIFIKUSHME.**

- Fidanishtet duhen të vendosen në toka që plotësojnë kërkesat bujqësore dhe që nuk kanë kultivuar pemë frutore për të paktën tre vjet.
- Toka duhet të jetë e pastër nga nematodat vektorë dhe ato endoparazite të dhëna në Aneksin 5 dhe duhen ti nënshtrohen një analize nematologjike sipas metodës së treguar në Aneksin 5.
- Fidanishtja duhet të ndahet në parcela homogjene dhe të identifikueshme qartë për varietete të ndryshme.

- Parcela duhet të rrethohet nga një bord së paku 2 metra, i cili duhet të punohet dhe të pastrohet nga çdo lloj vegjetacioni.
- Cdo rresht në parcelë duhet të përmbajë vetëm Prunoideae dhe kombinimet e ndryshme te shartimit duhet të vendosen në distancë një metër larg.
- Fidanishtja duhet të mbrohet mirë nga dëmtuesit dhe sëmundjet.
- Parcela duhet të jetë 10 metra larg nga pemëtoret e tjera.

# **ANALIZAT NEMATOLOGJIKE TE TOKES DHE TE BIMEVE NE BLLOQET MEME DHE NE FIDANISHTE.**

- A) *NEMATODAT VEKTORE TE VIRUSEVE*
- Toka duhet të jetë e pastër nga *Longidorus elongatus*, *L. attenuatus*, *L. macrosoma* dhe *xiphinema diversicaudatum*, *X. rivesi*, *X americanum* dhe *X californicum*.
- Mostrat duhen të merren në pranverë dhe në vjeshtë para punimit të tokës.
- Për çdo hektar duhen të merren 10 mostra, secila prej tyre duhet të përbëhet nga jo më shumë se 5 nënmostra

## B) NEMATODAT ENDOPARAZITE

- Toka duhet të jetë e pastër nga *Pratylenchus vulnus*, *P. penetrans*, *Melodogyne incognita*, *M. javanica*, *M. arenaria*, *M. hapla* dhe *Circonemella xenoplax*.
- Për çdo hektar duhen të merren 10 mostra secila prej tyre duhet të përbëhet nga jo më shumë se 5 nënmostra.
- Mostrat duhen të dërgohen menjëherë në një laborator të njojur zyrtarisht nga Komiteti Tekniko-Shkencor.